

LIGJ
Nr. 5/2020

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja “ë”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë, sipas këtij ligji, udhëhiqet nga parimet e:

- a) humanizmit;
- b) arritjes së qëllimit të dënimit;
- c) rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen;
- ç) edukimit dhe të rehabilitimit;
- d) mbrojtjes së interesit publik;
- dh) dhënies së mundësisë së integritetit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve, të mitur dhe femra.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “I dënuar” konsiderohet:

- a) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë për krime të rënda dhe që, brenda afatit ligjor, nuk është bërë ankim në gjykatat respektive të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës 31.12.2019;
- b) personi i dënuar deri në datën 31.12.2019 nga gjykatat respektive të apelit;
- c) personi i dënuar deri në datën 31.7.2017 nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit ka shqyrtuar çështjen në themel dhe ka disponuar me vendim, sipas parashikimeve të shkronjave “b”, “c” dhe “d”, të nenit 441, të Kodit të Procedurës Penale, dhe për personat e dënuar deri në datën 31.12.2019 nga Gjykata e Lartë, e cila ka disponuar me vendim, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të nenit 441, të Kodit të Procedurës Penale;
- ç) personi i dënuar deri në datën 31.7.2017 nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit ka gjykuar si shkallë e parë.

2. “Person që i është shmangur drejtësisë” është shtetasi, i cili i është shmangur ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit deri në datën 31.12.2019.

Neni 3

Kriteret për përfitimin e amnistisë

1. Amnistohen personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e

alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.

2. Amnistohen personat femra dhe të mitur, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdolloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.12.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi.

3. Amnistohen personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet.

4. Amnistohen personat femra dhe të mitur, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet.

5. Amnistohen personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç.

6. Amnistohen personat e dënuar meshkuj, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç.

7. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

8. Të gjithë të dënuarve femra dhe të mitur, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të përfutur amnisti, sipas pikave 2, 4, 5 dhe 7, të këtij neni, u zbritet 1/3 e dënimit të mbetur, pavarësisht kriterëve ndalues të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 4

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1, 3 dhe 6, të nenit 3, të këtij ligji, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar, për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75, të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83, 83/a, 83/b e 84/a, të Kodit Penal, si dhe në nenin 77, të Kodit Penal Ushtarak;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 96 e 99, të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a, të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenin 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111, të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 117, në nenet 119, 120, 121, të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, në paragrafët e dytë e të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b, 129 e 130/a, të Kodit Penal;

ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenin 134, në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 143, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, në paragrafin e dytë të nenit 156, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 e në nenin 181/a, të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;

f) vepra penale kundër falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë, të parashikuara në nenet 183, 184, në paragrafin e dytë të nenit 185, të Kodit Penal;

g) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në nenin 186, në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në nenet 188, 189 e 191, në paragrafin e dytë të nenit 192/b, të Kodit Penal;

gj) veprat penale kundër zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit, të parashikuara në nenin 197 të Kodit Penal;

h) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 199/a, të Kodit Penal;

i) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në nenet 201, 202, 203, 206/a, në paragrafin e dytë të nenit 206/b, të Kodit Penal;

j) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225, të Kodit Penal;

k) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 e 228, të Kodit Penal;

l) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 230/d, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b, të Kodit Penal;

ll) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 235, në paragrafin e dytë të nenit 236, në nenet 237, 238, 243, 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 248/a, 250, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 270, 274, në paragrafët e parë, të katërt, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë të nenit 278, në nenin 278/a, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenin 282/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 283, në nenet 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë, të katërt të nenit 290, në nenet 293, 293/a, 293/b, 293/c, 294, në paragrafët e parë, të tretë, të pestë dhe të gjashtë të nenit 295/a, në nenet 297, 298, 299, të Kodit Penal, dhe në nenin 70, të Kodit Penal Ushtarak;

m) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 302, në nenet 305, 305/a, 305/b, 306, në paragrafin e dytë të nenit 309, në nenet 312, 312/a, 313/a, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 313/b, në nenet 314, 316, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në nenet 323, 324, 324/a, të Kodit Penal;

n) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 326, 326/a, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a, të Kodit Penal;

nj) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 2, 4, 5 dhe 7, të nenit 3, të këtij ligji, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a e 75 të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c dhe 81 të Kodit Penal;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, në paragrafin e dytë të nenit 88 dhe 89/a, të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 106, 107/a dhe 108 të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b dhe 110/a, të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 124/b, në nenet 128/a dhe 128/b, të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 139, 140, 141, 151, 152, në paragrafin e dytë të nenit 156 dhe në paragrafin e dytë të nenit 159, të Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225, të Kodit Penal;

f) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 e 228, të Kodit Penal;

g) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 233, 234, 234/a dhe 234/b, të Kodit Penal;

gj) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 238, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 274, 278, 278/a, 282/a, 283/a, 284/a, 288 dhe 293, të Kodit Penal;

h) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

3. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të nenit 2, të këtij ligji.

4. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti subjektet e përcaktuara në pikat 1, 3 dhe 6, të nenit 3, të këtij ligji, në rast se janë përsëritës të së njëjtës vepër penale.

Neni 5

Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.1.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11439, datë 14.2.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.